

Ne promovojmë kulturë
gjithëpërfshirëse

Politika e Grupit TITAN për Diversitetit, Barazinë dhe Përfshirjen

Qershor 2025
v1.2

Përmbajtja

Qëllimi	3
Përkufizimet	3
Fushëveprimi dhe Zbatimi	3
Parimet	4
Paga e Barabartë	4
Ndryshimet e Arsyeshme	4
Menaxhmenti dhe Përgjegjësitë	4
Qeverisja dhe Monitorimi	4
Komunikimi	5
Si të paraqitet një shqetësim	5
Shkeljet	5
Administrimi dhe Përditësimi i Politikës	5

Qëllimi

Në TITAN, diversiteti, barazia dhe përfshirja (DE&I) janë thelbësore për kulturën, strategjinë dhe praktikën e përditshme të punës sonë. Ne jemi të përkushtuar për të krijuar një mjedis ku të gjitha dallimet vlerësohen dhe ku të gjithë kanë mundësinë të përparojnë dhe të përjetojnë ndjenjën e përkatësisë. Ne e kuptojmë se arritja e aspiratave tona për DE&I në punën që bëjmë dhe mënyrën se si punojmë është një proces i vazhdueshëm dhe që kërkon ndërgjegjësim, veprim, përgjegjësi dhe llogaridhënie nga të gjithë në biznesin tonë. Kjo politikë përcakton parimet, përkufizimet, fushëveprimin dhe qasjen tonë ndaj diversitetit dhe përfshirjes.

Përkufizimet

Barazia: Barazia në TITAN është pjesë e vlerave tona. Kjo do të thotë të sigurohemi që të gjithë punonjësit tanë të kenë mundësi të barabarta për të performuar, kontribuar dhe përparuar në kompaninë tonë. Do të thotë gjithashtu parandalim i disavantazhit, diskriminimit ose paragjykitimit bazuar në çdo karakteristikë të diversitetit. Në promovimin e barazisë brenda TITAN-it, ne zbatojmë dhe respektojmë ligjet lokale të vendeve ku veprojmë.

Diversiteti: TITANI çmon përparësinë që diversiteti sjell në biznesin tonë dhe ne aspirojmë ta rrisim atë. Diversiteti në TITAN i referohet çdo karakteristike që na bën të veçantë. Ai përfshin, por nuk mund të kufizohet në:

- **Identitetin ose Diversitetin Demografik**, duke përfshirë moshën, aftësinë e kufizuar, gjininë dhe identitetin gjinor, përkatësinë etnike dhe racën, fenë dhe besimet shpirtërore dhe jo-besimet, orientimin seksual, origjinën kombëtare;
- **Diversitetin në Përvojë**, të tilla si shkallësimi, aftësitë, arsimit dhe historiku;
- **Diversitetin Kognitiv dhe Neurologjik**, të tilla si mënyrat e të menduarit, të mësuarit, personaliteti dhe stili i punës.

Përfshirja: Ne aspirojmë të krijojmë një mjedis brenda TITAN-it ku të gjithë kanë një ndjenjë të fortë përkatësie dhe përjetojnë përfshirje. Përfshirja është shkalla në të cilën individët ndihen të vlerësuar, të respektuar, të sigurt dhe të pranuar.

Tallja (Bullizimi) dhe Ngacmimi: Kjo është sjellje që e bën dikë të ndihet i frikësuar ose i ofenduar. Kjo mund të përfshijë, për shembull, trajtimin e padrejtë, talljen, nënvlerësimin e dikujt ose mohimin e mundësive për trajnim ose promovim. Ajo përfshin talljen (bullizimin) dhe ngacmimin në çdo rrethanë dhe me çdo mjet, për shembull, ballë për ballë, përmes letrës, emailit, në platforma virtuale ose me telefon. Në TITAN, ne kemi një qasje me tolerancë zero ndaj talljes dhe ngacmimit dhe veprojmë sipas kërkesave të legjislationit vendas në lidhje me talljen dhe ngacmimin.

Fushëveprimi dhe Zbatimi

Kjo Politikë zbatohet në **TITAN S.A. dhe në të gjitha subjektet që ajo zotëron ose në të cilat mban shumicën e aksioneve (Grupi TITAN).**

Parimet e Politikës pritet të zbatohen gjithashtu nga partnerët dhe bashkëpunëtorët e biznesit të Grupit TITAN, si kontraktuesit dhe furnitorët.

Gjatë zbatimit të Politikës, ne u nënshtrohemi ligjeve të vendeve në të cilat veprojmë dhe jemi të përkushtuar të respektojmë të gjitha ligjet e tilla në fuqi. Aty ku politika, procedurat dhe angazhimet tona të jashtme janë më rigorozë se ligjet vendore, ne veprojmë në përputhje me standardet tona. Aty ku ligji vendas na ndalon të zbatojmë disa aspekte të Politikës, ne i zbatojmë këto ligje vendore duke zbatuar praktikën më të mirë.

Njësitë e biznesit dhe/ose rajonet mund të ndryshojnë praktikën e DE&I për t'iu përshtatur nevojave të tyre individuale, por vetëm nëse nuk bien ndesh me ndonjë nga deklaratat e Politikës së Grupit, ose nuk anashkalojnë aspekte të rëndësishme të Politikës së Grupit.

DE&I është i përfshirë në të gjitha politikën, strategjitë dhe planet përkatëse. Kjo politikë duhet lexuar në lidhje me:

- Kodin e Mirësjelljes së TITAN Group, Politikën e Përgjegjësisë Sociale të Korporatës, Politikën e të Drejtave të Njeriut dhe Politikën për Sinjalizuesit.
- Strategjinë tonë Mjedisore, Sociale dhe Qeverisëse (ESG), e cila përcakton angazhimin tonë për të kultivuar një kulturë gjithëpërfshirëse me mundësi të barabarta për të gjithë punonjësit tanë për të përparuar profesionalisht brenda një mjedisi të sigurt dhe të shëndetshëm në punë.

Parimet

1. Ne vlerësojmë të gjithë punonjësit tanë dhe zbatojmë praktikën e biznesit që **nuk tolerojnë diskriminimin**, dhe të cilat **promovojnë** mundësi të barabarta dhe **diversitet, barazi dhe përfshirje**, në rekrutim, punësim, zhvillim, menaxhim të talenteve dhe shpërblim dhe të cilat janë në përputhje me ligjet kombëtare dhe udhëzimet vullnetare ndërkombëtare, si p.sh. Deklarata Universale e OKB-së për të Drejtat e Njeriut, **Konventat e Organizatës Ndërkombëtare të Punës për Punën dhe Pakti Global i OKB-së**.
2. Të gjithë në TITAN mund të presin që të vlerësohen dhe respektohen për atë që janë. **Ne nuk tolerojmë diskriminim, talljen apo ngacmim.**
3. Ne njohim dhe jemi të përkushtuar ndaj **fokusit, të mësuarit dhe punës së vazhdueshme të monitorimit dhe rishikimit** që kërkohet për të arritur dhe mbështetur diversitetin, barazinë dhe përfshirjen.
4. Diversiteti, barazia dhe përfshirja janë **përgjegjësi e të gjithëve** në TITAN, në veprimet dhe sjelljet e tyre të përditshme.
5. Ne jemi **të përkushtuar për të arritur rezultate të barabarta** në punësim dhe kuptojmë se kjo mund të kërkojë veprime të ndryshme për punonjës të ndryshëm, duke marrë parasysh nevojat individuale, përvojën e diskriminimit në të kaluarën dhe/ose diskriminimit në sisteme më të gjera sociale, ekonomike dhe arsimore.
6. Kuptimi dhe tejkalimi i barrierave në fushën e diversitetit, barazisë dhe përfshirjes kërkon **një qasje bashkëpunuese dhe ne jemi të përkushtuar të përfshijmë punonjës dhe këndvështrime të ndryshme** nga i gjithë biznesi ynë për të siguruar që veprimet tona të kenë një ndikim pozitiv.

Paga e Barabartë

Jemi të përkushtuar të sigurojmë pagë të barabartë për punën që ka vlerë të barabartë dhe të shmangim diskriminimin e padrejtë lidhur me mënyrën se si i shpërblejmë punonjësit tanë në TITAN në bazë të gjinisë, racës/etnisë dhe aftësisë së kufizuar. Ne do t'i përgjigjemi menjëherë çdo ankese në lidhje me pagën e barabartë dhe kur konstatohet ndonjë pabarazi, jemi të përkushtuar të zbatojmë një plan për të rikthyer pagën e barabartë.

Ndryshimet e Arsyeshme

'Ndryshimi i arsyeshëm' ose 'përshtatja' i referohet modifikimeve/ndryshimeve të pajisjeve, mjedisit në vendin e punës, përmbajtjes së punës, mënyrës se si bëhen gjërat, si dhe orarit të punës dhe vendndodhjes për punonjësit me nevoja të ndryshme në mënyrë që ata të mund të përmbushin rolin e tyre ose të aplikojnë për një pozitë në TITAN. Kjo synon të mbështesë punonjësit me aftësi të kufizuara, punonjëset shtatzënë, ata/ato që duhet të kujdesen për dikë ose ata/ato që kanë ndryshime në gjendjen shëndetësore ku kërkohet të bëhen përshtatje për t'ua mundësuar atyre të bëjnë punën e tyre. Ne jemi të përkushtuar të bëjmë ndryshime/përshtatje aty ku është e mundur ose e arsyeshme, duke marrë parasysh: (1) ndikimin që do të ketë ndryshimi në zvogëlimin e pengesës së përjetuar nga punonjësi, (2) sa praktike janë ndryshimet e kërkuara (3) kostoja dhe përbalueshmëria dhe (4) ndikimi tek të tjerët duke përfshirë dëmtimin e mundshëm të shëndetit dhe sigurisë së tyre.

Menaxhmenti dhe Përgjegjësia

Çështjet e diversitetit, barazisë dhe përfshirjes mund të hasen në çdo ndërveprim personal që mund të kemi si menaxherë, mbikëqyrës, kolegë ose partnerë biznesi dhe në vendimet që marrim. Prandaj, të gjithë punonjësve të Grupit TITAN u kërkohet të lexojnë, kuptojnë dhe sigurohen që veprimet e tyre të jenë në përputhje me Politikën dhe inkurajohen të marrin pjesë në çdo trajnim, seminar ose ngjarje të ofruar brenda kompanisë për të mbështetur barazinë, diversitetin dhe përfshirjen.

Qeverisja dhe Monitorimi

Është krijuar Këshilli i Grupit për DE&I i cili promovon në mënyrë aktive diversitetin, barazinë dhe përfshirjen në nivel të Bordit dhe Menaxhmentit dhe në të gjithë Grupin. Duke mbajtur përgjegjësinë e Grupit TITAN për strategjinë DE&I, iniciativat globale, komunikimin e brendshëm dhe të jashtëm dhe vlerësimin e progresit lidhur me objektivat, Këshilli i raporton Bordit të Drejtorëve të TITAN-it, nëpërmjet Kryesuesit të tij.

Vendet inkurajohen të krijojnë Këshillat e DE&I - ose të përfshijnë DE&I si një llogaridhënie të shtuar për Komitetet Menaxhuese në Vend - duke vepruar si promovues aktivë në nivel lokal dhe duke nxitur zbatimin e zgjidhjeve lokale për të përmirësuar DE&I, në përputhje me strategjinë e Grupit për DE&I, duke pasur parasysh nevojat lokale, kontekste të ndryshme rregullatore dhe veprimet e ndryshme.

Komunikimi

Politika DE&I e Grupit TITAN duhet t'u komunikohet të gjithë punonjësve, si dhe furnitorëve, kontraktuesve, agjentëve dhe partnerëve të biznesit në fillim të marrëdhënies sonë me ta. Ne i komunikojmë të paktën çdo vit objektivat tona, planet e veprimit dhe progresin e arritur brenda dhe jashtë në fushën e DE&I.

Si të paraqitet një shqetësim

Nëse keni përjetuar ose parë sjellje ose veprime që bien ndesh me politikën tonë të DE&I ose nëse keni një kërkesë për një ndryshim / përshtatje të arsyeshme, duhet ta diskutoni ose ta raportoni këtë menjëherë te:

- Menaxheri juaj i drejtpërdrejt dhe/ose
- Punonjësi në burimet njerëzore (BNj)
- EthicsPoint

Nëse keni ndonjë pyetje ose kërkonte sqarime në lidhje me këtë Politikë, ju lutemi kontaktoni menaxherin tuaj të drejtpërdrejt dhe/ose përfaqësuesin tuaj vendor në burimet njerëzore.

Shkeljet

Shkeljet e kësaj Politike mund të rezultojnë në masa disiplinore, duke përfshirë largimin nga puna, sipas ligjeve dhe rregulloreve lokale. Kur një veprim është gjithashtu në kundërshtim me ligjin, punonjësi mund t'i nënshtrohet ndjekjes penale sipas ligjit civil ose penal. Varësisht nga rrethanat, punonjësi i cili e shkelë Politikën mund t'i ofrohet trajnim dhe t'i jepen objektiva që do të monitorohen nga afër për të ndryshuar veprimet dhe sjelljet.

Administrimi dhe Përditësimi i Politikës

Departamenti i Burimeve Njerëzore i Grupit TITAN është përgjegjës për administrimin, rishikimin dhe përditësimin periodik të kësaj Politike. Rishikimet do t'i dorëzohen për miratim Komitetit Ekzekutiv të Grupit.